



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRI E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSIMIT RREGULLATOR DHE PËRPTITHMËRISË
DREJTORIA E INSPEKTIMIT FINANCIAR PUBLIK

cu prot 4063/2
05.11.2021

Tiranë, më: 08.11.2021

Lënda: Kërkesë për vënie dokumentacioni në dispozicion dhe mjedisit të punës për Inspektorët Financiarë Publik.

Drejtuar: Personit të kontaktit:
- Z. Eldorado KICE, Drejtor, Drejtoria e Hidrokarbureve, në cilësinë e Personit të kontaktit
- Z. Bledar PAPALHO, Drejtor, Drejtoria Juridike, në cilësinë e Personit të kontaktit
- Znj. Zhuljeta MITRE, Drejtor, Drejtoria Ekonomike, në cilësinë e Personit të kontaktit
(Për zbatimin e Vendimit nr. 91, datë 05.11.2021 "Për fillimin e inspektimit financiar publik")

Mbështetur në Vendimin e Nëpunësit të Parë Autorizues, nr. 91 datë 05.11.2021 "Për fillimin e inspektimit financiar publik", (Prot. në MFE me nr. 1229/9 Prot, datë 05.11.2021 dhe në subjektin/ AKBN, nr. Prot, datë 2021) dhe kërkesave të pikës 4/4.2" a", "b" & 5/ 5.1-5.8 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.11.2015 "Për rregullat dhe procedurat e kryerjes së inspektimit financiar publik", kërkojmë vënien në dispozicion të dokumentacionit nga struktura përgjegjëse, për objektin e inspektimit sipas vendimit të inspektimit si më sipër, si më poshtë vijon:

- Rregullore e brendshme e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për vitin 2017 e në vijim.
- Baza ligjore mbi organizimin dhe funksionimin e AKBN-së.
- Struktura organike e Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për vitin 2017 e në vijim.
- Marrveshja hidrokarbure e lidhur ndërmjet shoqërisë Albpetrol sh.a dhe shoqërisë TransAtlantik Albania (ish Stream Oil & Gas Ltd) për vendburimet... Cakran - Mollaj dhe Gorisht-Kocul..., miratuar me VKM nr. 509, datë 08.08.2017 "Miratimi i Marrveshje Hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet Ballsh-heka, Cakran - Mollaj, Gorisht-Kocul dhe në vendburimet e Delvinës ndërmjet "Albpetrol" sh.a dhe Stream Oil&Gas Ltd.

- Korrespondenca shkresore zyrtare ndërmjet Agjensisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, shoqërisë Albpetrol sh.a si dhe Degës së Doganës Fier, lidhur me gjendjen/sasinë e naftës prej 817.99 m³ në magazinat fiskale në vendburimin Cakran-Mollaj në shfrytëzim nga shoqëria TransAtlantik Ltd. (Dokumentimi i të gjithë procesit lidhur me administrimin e magazinave fiskale për këtë sasi naftë nga AKBN, shoqëria Albpetrol sh.a si dhe Dega e Doganës Fier).
 - Korrespondenca shkresore zyrtare ndërmjet AKBN-së dhe MIE/struktura përkatëse lidhur me monitorimin dhe ecurinë e kësaj marrveshje/raportimet nga AKBN si dhe miratimi i tyre nga MIE/struktura përkatëse.
 - Korrespondenca shkresore zyrtare ndërmjet AKBN-së dhe shoqërisë Albpetrol sh.a, lidhur me monitorimin dhe ecurinë e kësaj marrveshje/raportimet nga kjo e fundit për AKBN.
 - Korrespondenca shkresore zyrtare ndërmjet AKBN-së, shoqërisë Albpetrol sh.a dhe shoqërisë TransAtlantik Ltd, lidhur me afatin/datën e përfundimit/mbylljes së marrveshjes hidrokarbure të lidhur me Transatlantik Ltd.
 - Urdhri i brendshëm i Titiullarit/Personit të autorizuar/deleguar, të AKBN-së për ngritjen e Grupit të punës për marrjen në dorëzim të vendburimit Cakran -Mollaj me përfaqësues të AKBN-së. (Korrespondenca shkresore zyrtare ndërmjet AKBN-së dhe shoqërisë Albpetrol sh.a, lidhur me caktimin e përfaqësuesit /ëve të AKBN-së për marrjen në dorëzim të vendburimit Cakran -Mollaj, me përfundimin e marrveshjes me TransAtlantik Ltd, referuar Urdhrit të ish Ministrit të MEI nr.34, datë 01.02.2017).
 - Dokumentimi i të gjithë procesit të marrjes në dorëzim nga ana e personave/grup pune të sasisë së naftës gjendje në depozitat e ndërhuara për këtë qëllim, të prodhuar nga vendburimi Cakran-Mollaj në shfrytëzim nga ana e Transatlantik Ltd, me përfundimin e marrveshjes nga ky i fundit/process verbal i marrjes në dorëzim, Fletë hyrje e magazinës, etj dokumenta.
 - Korrespondenca shkresore zyrtare ndërmjet AKBN-së dhe shoqërisë Albpetrol sh.a, lidhur me marrjen nga AKBN e të gjitha asetëve /vendburimeve që ka patur në shfrytëzim shoqëria TransAtlantik Ltd, me përfundimin e marrveshjes së lidhur.
 - Dokumentacioni ligjor justifikues administruar nga AKBN për shoqërinë Albpetrol sh.a lidhur me zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë Albpetrol sh.a për të gjithë vlerën e asetëve në shfrytëzim nga Transatlantik Ltd, me përfundimin e marrveshjes nga ky i fundit.
 - Çdo dokumentacion i nevojshëm dhe i domosdoshëm shkresor zyrtar në funksion të zbatimit dhe ecurisë të kësaj marrveshje të lidhur me shoqërinë Trasatlantik Albania Ltd.
- Dokumentacioni i kërkuar të vihet në dispozicion të Grupit të inspektimit, brenda datës 12.11.2021, i njesuar me origjinalin dhe vulosur me vulë të njomë të institucionit/AKBN.

Falenderime dhe punë të mbarë.

GRUPI I INSPEKTIMIT

Z. Shemsi Mikli

Z. Osman Losha

